

## **Prezantohen në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, raportet e para shkencore të projekteve fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit**

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", janë prezantuar raportet e para shkencore të projekteve fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), në fushën e mësimdhënies dhe biznesit.

Ky aktivitet u fokusua në rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes dhe cilësisë së kërkimit shkencor, rritjen e projekteve kërkimore me në fokus bashkëpunimet që kontribuojnë në zhvillimin akademik dhe që adresojnë çështje të zhvillimit ekonomik. Prej vitesh Universiteti i Elbasanit, ndjek një strategji të suksesshme të ndërkombëtarizimit, duke ndërmarrë një sërë iniciativash me në fokus studentin dhe personelin akademik.



